

URDHËR
Nr. 69, datë 30.1.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 22 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për:

a) organizimin dhe fillimin e procedurave të prokurimit të institucionit me fondet publike, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar;

b) nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) miratimin e procedurave të emërimit dhe të lirimit nga detyra të personelit administrativ e teknik, në misionet diplomatike/postet konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit;

ç) miratimin e procedurave të emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të kontraktuar në zbatim të vendimit nr. 16, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore”;

d) miratimin e shpenzimeve financiare për veprimtaritë protokollare, pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja, deri në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri deri në datën 31.12.2019.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
dhe MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Edi Rama